VENDIM
Nr.9, datë 29.1.2010

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË "HIDROINVEST 1" SHPK PËR NDRYSHIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT (ZOTËRON PAKETËN KONTROLLUESE)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 6.2 të "Licencës për prodhimin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.1.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Hidroinvest 1" sh.p.k., për marrjen e autorizimit për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

dhe konstatoi se:

1. Shoqëria "Hidroinvest 1" sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, datë 24.9.2008.

2. Propozimi për shitjen e aksioneve të "Hidroinvest 1" sh.p.k., shkakton ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat.

3. Ndryshimi i aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë i shërben shtimit të kapacitetit teknik të kompanisë dhe uljes në mënyrë të ndjeshme të nivelit të kreditimit nga bankat për realizimin e investimit, si dhe në përmbushjen e detyrimeve të marrëveshjes së koncesionit dhe licencës së prodhimit të energjisë elektrike,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të autorizojë shoqërinë "Hidroinvest 1" sh.p.k., për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta